



Datë: 29 mars 2017

Prot: 8

LETËR SHOQËRUESE

Lënda: Raportimi financiar për datën 31 dhjetor 2016

Shoqëria Albanian Highway Concession sh.p.k ("Shoqëria") është themeluar më 27 dhjetor 2016 në përputhje me kërkesat e klauzolës 1.9 dhe 2A të Marrëveshjes së Koncencionit datë 6 dhjetor 2016 për Ndërtimin, Përmirësimin, Shfrytëzimin (duke përfshirë vjeljen e taksave të rrugës) dhe Mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë.

Shoqëria **nuk ka pasur aktivitet operacional për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016** për rrjedhonë nuk ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti.

- 1. Pasqyrat Financiare me 31 dhjetor 2016:** Ppasqyra financiare të Shoqërisë, janë pasqyra për qëllime të përgjithshme raportimi ligjor dhe janë përgatitur sipas kërkesave të ligjit "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" nr. 9228 datë 29 prill 2004 dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Në periudhën e parë raportuese pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Koncencionit, Shoqëria do të përgatisë pasqyrat e saj financiare me 31 dhjetor 2017 sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").
- 2. Mjete transporti:**
Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka pasur në pronësi ose në përdorim automjete.
- 3. Kontrata qeraje:**
Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka pasur kontrata qeraje të lidhura dhe në fuqi.
- 4. Aktive në pronësi:**
Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka pasur aktive afatgjata në pronësi.
- 5. Inventarë:**
Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka pasur inventarë.

Për sa më sipër mbetemi në dispozicion për çdo informacion dhe/ose sqarim të detajuar të kërkuar nga ana juaj.

Albanian Highway Concession sh.p.k

Dolores Behari

Dolores BEHARI
Administrator



Albanian Highway Concession sh.p.k

*Pasqyrat Financiare më dhe për
periudhën nga data 27 dhjetor 2016
në 31 dhjetor 2016*



Përmbajtje

PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimit në kapital	3
Pasqyra e fluksit të parasë	4
Shënime për pasqyrat financiare	5- 9



ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016
(vlerat në LEK)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2016
AKTIVE		
Aktive korrente		
Para në arkë dhe bankë		-
Llogari të arkëtueshme	4	1,000,000
Inventarë		-
Aktive të tjera korrente		-
Totali i aktiveve korrente		<u>1,000,000</u>
Aktive jo-korrente		
Totali i aktiveve jo-korrente		<u>-</u>
TOTALI I AKTIVEVE		<u><u>1,000,000</u></u>
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Kapitali		
Kapitali aksionar	5	1,000,000
Rezerva		-
Humbja e periudhës		(470)
Totali i kapitalit		<u>999,530</u>
Detyrime korrente		
Detyrime bankare dhe të ngjashme	3	470
Detyrime të tjera korrente		-
Totali i detyrimeve korrente		<u>470</u>
Detyrime jo-korrente		-
Totali i detyrimeve jo-korrente		<u>-</u>
Totali i detyrimeve		<u>470</u>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		<u><u>1,000,000</u></u>

Pasqyrat financiare të Albanian Highway Concession sh.p.k janë aprovuar nga aksionarët më 29 mars 2017 dhe janë firmosur nga:

Dolores Behari
 Dolores Behari
 Administrator



Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 8 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

[Signature]
 1


ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

	Shënime	Periudha nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Të ardhura		-
Shpenzime operative		-
Rezultati neto nga aktiviteti operativ		-
Shpenzime administrative		
Shpenzime të tjera	6	470
Totali i shpenzimeve administrative		470
Humbje para tatim fitimit		470
Tatimi mbi fitimin		-
HUMBJA NETO E PERIUDHËS		470

Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 8 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.



2

ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016***(vlerat në LEK)*

	Kapitali i regjistruar i pa-paguar	Rezerva	Humbje e periudhës	Totali
Kapitali i regjistruar i pa-paguar më 27 dhjetor 2016	1,000,000	-	-	1,000,000
Humbja e periudhës	-	-	(470)	(470)
Balanca më 31 dhjetor 2016	1,000,000	-	(470)	999,530

Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 8 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.


ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

Shënime	Periudha nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETI OPERATIV	
Humbja para tatimit	(470)
<i>Rregullime për:</i>	
Shpenzime për interesat	474
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative para rregullimeve në kapitalin qarkullues	<u>4</u>
Rritje të detyrimeve bankare dhe të ngjashme	470
Fluksi i parasë i gjeneruar nga aktivitetet operative	<u>474</u>
Tatim fitimi i paguar	-
Interesa, komisione të paguara	(474)
Fluksi i parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative	<u>-</u>
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE	
Blerje të ndryshme	-
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese	<u>-</u>
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE FINANCUESE	
Te hyra nga disbursim huaje dhe të ngjashme	-
Fluksi i parasë neto përdorur për aktivitetet financuese	<u>-</u>
Fluksi neto i parasë dhe ekuivalentët	<u>-</u>
Para dhe ekuivalentë në fillim të periudhës	-
Para dhe ekuivalentë në fund të periudhës	<u>-</u>

Shënimet bashkëngjitur nga 1 në 8 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare



ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Bashkimi i Shoqërive Catalyst Viva Das General Contracting LLC, Salillari sh.p.k, Violiap Ateve, Bee Tech and Kastrati sh.a (referuar si "Koncesionari") më 6 dhjetor 2016 ka nënshkruar me Qeverinë e Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Marrëveshjen e Koncesionit (referuar si "Marrëveshja") për Ndërtimin, Përmirësimin, Shfrytëzimin (duke përfshirë vjeljen e taksave të rrugës) dhe Mirëmbajtjen e Autostradës Milot-Morinë. Marrëveshja e Koncesionit e sipërcituar është aprovuar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 870 datë 14 dhjetor 2016.

Më 27 dhjetor 2016, në përputhje me kërkesat e klauzolës 1.9 dhe 2A të Marrëveshjes së Koncesionit, Koncesionari ka themeluar Shoqërinë Koncesionare Albanian Highway Concession sh.p.k ("Shoqëria") me NUIS L62427021G e seli qendrore në Rrugën Vorë-Marikaj km.1, Vorë, Tiranë, Shqipëri. Sipas kërkesave të Marrëveshjes, Koncesionari i ka transferuar të drejtat dhe detyrimet e Marrëveshjes Shoqërisë e cila në vazhdim zëvendëson Koncesionarin.

Periudha e Koncesionit do të jetë 30 vjet në përputhje me klauzolën 3 të Marrëveshjes dhe fillon në datën e hyrjes në fuqi. Më 31 dhjetor 2016 Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi. Marrëveshja hyn në fuqi me përmbushjen e Kushteve Paraprake të përcaktuara në klauzolën 2 të Marrëveshjes.

2. BAZAT E PËRGATITJES TE PASQYRAVE FINANCIARE

Këto pasqyra financiare, janë pasqyra për qëllime të përgjithshme raportimi ligjor dhe janë përgatitur sipas kërkesave të ligjit "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" nr. 9228 datë 29 prill 2004 dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

Në periudhën e parë raportuese pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Koncesionit, Shoqëria do të përgatisë pasqyrat e saj financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").



5

ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

3.1. Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Shoqërisë është Leku Shqiptar (LEK), e cila është monedha e përdorur në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria ushtron veprimtarinë. Shoqëria përgatit dhe raporton pasqyrat e saj financiare në LEK. Transaksionet konvertohen fillimisht duke përdorur kursin e këmbimit midis monedhës së huaj dhe monedhës funksionale në momentin e kryerjes së veprimit që është momenti kur veprimi kualifikohet për njohje në pasqyrat financiare. Në fund të çdo periudhe raportuese, aktivet monetare konvertohen me kursin e fundit të periudhës raportuese. Aktivet jo-monetare mbahen me kosto historike dhe konvertohen në monedhën raportuese me kurset historike të transaksioneve.

Kursi i këmbimit të LEK-ut përkundrejt monedhës Euro më 31 dhjetor 2016 është si në vijim:

31 dhjetor 2016

LEK/EURO

135.23

Për aktivet monetare, diferencat që rezultojnë nga konvertimi reflektohen në rezultatin e vitit. Kur diferencat rezultojnë nga zëra jomonetarë ato kalojnë në fitim ose humbje; çfarëdo difference e realizuar nga këmbimet valutore kalon në rezultatin e periudhës. Kur fitimi dhe humbja e zërave jomonetarë njihen në kapitalin neto, edhe diferencat nga këmbimet njihen në kapitalin neto.

3.2. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë llogari rrjedhëse bankare, para në dorë, depozita me bankat dhe të tjera mjete që janë likuide dhe maturiteti i tyre i mbetur në një datë raportimi nuk është më shumë se 3 muaj.

3.3. Instrumenta financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet pjesë e një marrëdhënieje kontraktuale me të tretë në lidhje me këto instrumenta financiare.



ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

3.4. Aktive financiare

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera janë aktive financiare që përfaqësojnë një të drejtë kontraktuale për të marrë para në të ardhmen.

3.5. Të ardhurat

Të ardhura konsiderohen hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat lindin si pasojë e veprimtarisë dhe aktivitetit normal të Shoqërisë. Të ardhurat përfshijnë elementë të tillë si të ardhurat nga tarifa e rrugës, shitje, tarifa shërbimi, interesa, subvencionet qeveritare, pagesa direkte nga qeveria etj.

Në periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti.

E ardhura matet me vlerën e drejtë të përfitimeve të marra ose të arkëtueshme. Vlera e të ardhurave njihet neto nga zbritjet tregtare ose rabatet e marra.

3.6. Shpenzime huamarrje

Të gjitha shpenzimet e huamarrjeve dhe shpenzimet financiare të tjera njihen direkt në rezultatin e vitit në momentin kur ndodhin.

3.7. Tatim fitimi

Shpenzimi për tatim fitimin përfaqëson totalin e tatim fitimit të periudhës. Shpenzimi i vitit për tatim fitimin përllëgaritet duke përdorur normën e tatim fitimit e cila është e aplikueshme në fund të periudhës raportuese.

Shoqëria për periudhën nga 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016 nuk ka pasur aktivitet dhe për rrjedhojë nuk ka gjeneruar të ardhura të tatueshme.



7

ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

4. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Më 31 dhjetor 2016 llogaritë e arkëtueshme në vlerën 1,000,000 LEK përfaqëson vlerën e kapitalit të regjistruar të pa-paguar nga aksionarët.

5. KAPITALI AKSIONAR

Më 27 dhjetor 2016, në përputhje me kërkesat e klauzolës 1.9 dhe 2A të Marrëveshjes së Koncencionit, Koncesionari ka themeluar Shoqërinë Koncesionare Albanian Highway Concession sh.p.k (“Shoqëria”) me NUIS L62427021G e seli qendrore në Rrugën Vorë-Marikaj km.1, Vorë, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2016 kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 1,000,000 LEK i ndarë sipas strukturës në vijim:

	%	31 dhjetor 2016
Catalyst Viva Das General Constructing LLC	40	400,000
Salillari sh.p.k	30	300,000
Kastrati sh.a.	10	100,000
Bee Tech	10	100,000
Violiap A.T.E.V.E	10	100,000
Totali		<u>1,000,000</u>

Kapitali aksionar më 31 dhjetor 2016 ka qenë i pa-paguar dhe është njohur si detyrim i aksionarëve ndaj Shoqërisë për kontributin e kapitalit. Kapitali aksionar i regjistruar është paguar në 5 janar 2017.

6. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016 përfaqësojnë shpenzime dhe komisione bankare.

ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION SH.P.K

Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016

(vlerat në LEK)

7. TATIM FITIMI

Shoqëria për periudhën nga data 27 dhjetor 2016 deri më 31 dhjetor 2016 nuk ka pasur aktivitet dhe për rrjedhojë nuk janë gjeneruar të ardhura të tatueshme.

**Periudha nga data
27 dhjetor 2016 deri
më 31 dhjetor 2016**

Fitimi para tatimit

-

*Diferenca të përkohshme për të cilat nuk
është njohur tatim i shtyrë:*

-

Rregullime për shpenzime të panjohura:

-

Fitim i tatueshëm i vitit

-

Shpenzimi për tatim fitimin me 15%

-

8. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare, nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

